

**UDHËZIM**  
**Nr. 15267, datë 21.12.2018**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TEKNIKE LIDHUR ME KARAKTERISTIKAT  
FUNKSIONALE TË SISTEMEVE DHE TË PAJISJEVE DHE GJENDJES TEKNIKO-  
FIZIKE TË AUTOMJETEVE QË DO TË IMPORTOHEN NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 79, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe pikës 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 26.10.2018, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë

**UDHËZON:**

**I. QËLLIMI**

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve teknike lidhur me karakteristikat funksionale të sistemeve dhe të pajisjeve dhe gjendjes tekniko-fizike të automjeteve që importohen në Republikën e Shqipërisë, sipas kërkesave të VKM-së nr. 633, datë 26.10.2018.

**II. PËRKUFIZIME**

1. Për efekt të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) Kategoritë e mjeteve motorike, sipas nenit 47, të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, janë si më poshtë:

- “Kategoria M1”, janë mjete të destinuar për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota, që nuk kanë më shumë se tetë ndenjësë, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit;

- “Kategoria M2”, janë mjete të destinuar për transport njerëzish dhe që kanë të paktën katër rrota, që kanë më shumë se tetë ndenjësë, përveç ndenjësës së drejtuesit të mjetit dhe peshë maksimale me ngarkesë deri 5 tonë;

- “Kategoria N1”, janë mjete të destinuar për transport mallrash dhe që kanë të paktën katër rrota, që kanë peshë maksimale me ngarkesë jo më të madhe se 3,5 tonë;

b) Normat e shkarkimeve në ajër për mjetet motorike të kategorive M dhe N, sipas listës së standardeve të Bashkimit Evropian, përkatësisht, të shtojës 1, janë si më poshtë:

- “Euro 3”, janë për mjetet motorike, të cilat përmbushin normën euro 3, sipas listës së standardeve të vitit 2000, hyrë në fuqi me direktivën 98/69/EC;

- “Euro 4”, janë për mjetet motorike, të cilat përmbushin normën euro 4, sipas listës së standardeve të vitit 2005, hyrë në fuqi me direktivën 98/69/EC dhe 2002/80/EC;

- “Euro 5”, janë për mjetet motorike, të cilat përmbushin normën euro 5, sipas listës së standardeve të vitit 2009, hyrë në fuqi me direktivën 715/2007/EC;

c) “Autoriteti Verifikues”, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), që do të verifikojë përputhjen e kushteve teknike lidhur me karakteristikat funksionale të sistemeve dhe të pajisjeve dhe gjendjes tekniko-fizike të tyre, për mjetet motorike të kategorive M1, M2 dhe N1, që do të importohen në Republikën e Shqipërisë.

**III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT**

1. Mjetet motorike të kategorive M1, M2 dhe N1, që do të importohen në Republikën e Shqipërisë, verifikohen sipas përcaktimeve të këtij kreu dhe sipas vlerave të shkarkimeve për mjetet motorike, të përcaktuara në shtojcën 1 të këtij udhëzimi.

2. Verifikimi, pas këqyrjes së kujdesshme të mjetit dhe kontrollit të dhënave me dokumentacionin teknik shoqëruar të tij nga specialistët përkatës, konsiston në:

a) Leximin dhe përcaktimin e saktë të dhënave mbi identifikimin e mjetit, bazë e të cilit është numri i identifikimit i stampuar në shasi dhe/ose pllaka identifikuese;

b) Viti i prodhimit të mjetit;

c) Verifikimin e kategorisë mjedisore sipas përcaktimeve në dokumentin teknik të origjinës, si dhe verifikimin e standardit për normat e publikuara për mjete të prodhuara jo për vendet e Bashkimit Evropian;

d) Në mungesë të kategorisë mjedisore në dokumentin teknik të origjinës, do të jetë kriter vlerësues viti i prodhimit, por gjithmonë nëse nuk ka të dokumentuar nivel të ndotjes në kundërshtim me pikën 1 të këtij udhëzimi;

e) Çdo verifikim tjetër të nevojshëm për zbatimin e VKM-së nr. 633, datë 26.10.2018, “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, si dhe këtij udhëzimi.

3. Verifikimi bëhet nga punonjës të Autoritetit Verifikues.

4. Çlirimi doganor dhe/ose regjistrimi do të refuzohet të kryhet për mjetet motorike të kategorive M1, M2 dhe N1, për:

a) Autoveturat e reja me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat nuk përmbushin normën euro 5;

b) Mjetet motorike të tjera të reja të kategorive M2 dhe N1, me zero km dhe që nuk janë regjistruar më parë për qarkullim në asnjë shtet tjetër, të cilat nuk përmbushin normën euro 5;

c) Autoveturat e përdorura (të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat nuk përmbushin normën euro 4) dhe janë prodhuar jo më shumë se 10 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri;

ç) Mjetet motorike të tjera të përdorura, të kategorive M2 dhe N1 (të gjitha ato që nuk janë me zero km dhe që janë regjistruar më parë për qarkullim në rrugë në një shtet tjetër, të cilat nuk përmbushin normën euro 3) dhe janë prodhuar jo më shumë se 15 vjet para datës së regjistrimit të parë në Shqipëri.

5. Në rastet e parashikuara në pikën 4, Autoriteti Verifikues konstatues lëshon procesverbalin përkatës, i firmosur dhe i vulosur, në të cilin pasqyrohen saktësisht argumentet teknike dhe ligjore për moskryerjen e shërbimit.

6. Kur mungojnë të dhënat në dokumentin me treguesit teknikë shoqërues të mjetit për vitin e prodhimit dhe normën euro duhet të konsultohen manualët teknike ekzistuese, manualët teknike të publikuara nga konstruktorët ose përfaqësues të konstruktorëve, faqet elektronike zyrtare të institucioneve përgjegjëse ose të përdoret komunikimi direkt zyrtar me institucionet përgjegjëse, përfaqësuesit e autorizuar etj.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të planifikojë dhe të miratojë në programin e saj ekonomik fonde financiare për të gjitha shpenzimet e nevojshme për të siguruar të dhënat teknike për kategorinë përkatëse mjedisore, të konfirmuara nga institucione apo organizma përgjegjës, për të gjitha mjetet motorike kur është i nevojshëm ky konfirmim.

8. Punonjësit e Drejtorisë Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor që do të kryejnë verifikimin e mjeteve motorike të kategorive M1, M2 dhe N1, në plotësimin e kushteve teknike lidhur me karakteristikat funksionale të sistemeve dhe pajisjeve dhe gjendjes tekniko-fizike të tyre, duhet të jenë të profesionit inxhinier mekanik me eksperiencë pune në fushën e transportit rrugor.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor bashkëpunojnë për zbatimin e këtij udhëzimi.

10. Përrjashtohen nga verifikimi mjetet motorike të përcaktuara në pikën 3, të VKM-së nr. 633, datë 26.10.2018.

#### IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij udhëzimi dhe për bashkëpunim të ndërsjellë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË  
**Damian Gjikhuri**

SHTOJCA 1  
VLERAT E SHKARKIMEVE PËR MJETET MOTORIK

Shkarkimet standarde për mjetet motorike për transport njerëzish (M <sub>1</sub> , M <sub>2</sub> )*							
Norma	Datë	CO	HC	HC+NO <sub>x</sub>	NO <sub>x</sub>	PM	PN
		<i>g/ km</i>					
<b>Kompresim me injektim (diezel)</b>							
<b>Euro 1†</b>	1992.07	2.72 (3.16)	-	0.97 (1.13)	-	0.14 (0.18)	-
<b>Euro 2, IDI</b>	1996.01	1.0	-	0.7	-	0.08	-
<b>Euro 2, DI</b>	1996.01 <sup>a</sup>	1.0	-	0.9	-	0.10	-
<b>Euro 3</b>	2000.01	0.64	-	0.56	0.50	0.05	-
<b>Euro 4</b>	2005.01	0.50	-	0.30	0.25	0.025	-
<b>Euro 5a</b>	2009.09 <sup>b</sup>	0.50	-	0.23	0.18	0.005 <sup>f</sup>	-
<b>Euro 5b</b>	2011.09 <sup>c</sup>	0.50	-	0.23	0.18	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>
<b>Injektim pozitiv (gazolinë)</b>							
<b>Euro 1†</b>	1992.07	2.72 (3.16)	-	0.97 (1.13)	-	-	-
<b>Euro 2</b>	1996.01	2.2	-	0.5	-	-	-
<b>Euro 3</b>	2000.01	2.30	0.20	-	0.15	-	-
<b>Euro 4</b>	2005.01	1.0	0.10	-	0.08	-	-
<b>Euro 5</b>	2009.09 <sup>b</sup>	1.0	0.10 <sup>d</sup>	-	0.06	0.005 <sup>e,f</sup>	-
<p><b>Shënime:</b>  * Për normat euro 1-4, mjetet motorike për njerëzit &gt; 2,500 kg të aprovuara si mjete të kategorisë N<sub>1</sub>  † Vlerat në kllapa janë konformitetet i limiteve të prodhimit (COP)  a. deri 1999.09.30 (mbas kësaj date motorët DI duhet të arrijnë limitet e IDI)  b. 2011.01 për të gjitha modelet</p>							

c. 2013.01 për të gjitha modelet

d. dhe NMHC = 0.068 g/km

e. e aplikueshme vetëm për mjetet përdorin motorë DI

f. 0.0045 g/km që përdorin procedurat e matjes PMP

### Shkarkimet Standarde për mjetet motorike për transport mallrash (N<sub>1</sub>, N<sub>2</sub>)

Kategoria†	Norma	Data	CO	HC	HC+NO <sub>x</sub>	NO <sub>x</sub>	PM	PN
<b>Kompresim me injektim (diezel)</b>								
<b>N<sub>1</sub>, klasa I ≤1305 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	2.72	-	0.97	-	0.14	-
	<b>Euro 2 IDI</b>	1998.01	1.0	-	0.70	-	0.08	-
	<b>Euro 2 DI</b>	1998.01 <sup>a</sup>	1.0	-	0.90	-	0.10	-
	<b>Euro 3</b>	2000.01	0.64	-	0.56	0.50	0.05	-
	<b>Euro 4</b>	2005.01	0.50	-	0.30	0.25	0.025	-
	<b>Euro 5a</b>	2009.09 <sup>b</sup>	0.50	-	0.23	0.18	0.005 <sup>f</sup>	-
	<b>Euro 5b</b>	2011.09 <sup>d</sup>	0.50	-	0.23	0.18	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>
<b>N<sub>1</sub>, klasa II 1305-1760 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	5.17	-	1.40	-	0.19	-
	<b>Euro 2 IDI</b>	1998.01	1.25	-	1.0	-	0.12	-
	<b>Euro 2 DI</b>	1998.01 <sup>a</sup>	1.25	-	1.30	-	0.14	-
	<b>Euro 3</b>	2001.01	0.80	-	0.72	0.65	0.07	-
	<b>Euro 4</b>	2006.01	0.63	-	0.39	0.33	0.04	-
	<b>Euro 5a</b>	2010.09 <sup>c</sup>	0.63	-	0.295	0.235	0.005 <sup>f</sup>	-
	<b>Euro 5b</b>	2011.09 <sup>d</sup>	0.63	-	0.295	0.235	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>
	<b>Euro 6</b>	2015.09	0.63	-	0.195	0.105	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>

<b>N<sub>1</sub>, klasa III &gt;1760 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	6.90	-	1.70	-	0.25	-
	<b>Euro 2 IDI</b>	1998.01	1.5	-	1.20	-	0.17	-
	<b>Euro 2 DI</b>	1998.01 <sup>a</sup>	1.5	-	1.60	-	0.20	-
	<b>Euro 3</b>	2001.01	0.95	-	0.86	0.78	0.10	-
	<b>Euro 4</b>	2006.01	0.74	-	0.46	0.39	0.06	-
	<b>Euro 5a</b>	2010.09 <sup>c</sup>	0.74	-	0.350	0.280	0.005 <sup>f</sup>	-
	<b>Euro 5b</b>	2011.09 <sup>d</sup>	0.74	-	0.350	0.280	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>
	<b>Euro 6</b>	2015.09	0.74	-	0.215	0.125	0.005 <sup>f</sup>	6.0×10 <sup>11</sup>
<b>Injektim pozitiv (gazolinë)</b>								
<b>N<sub>1</sub>, klasa I ≤1305 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	2.72	-	0.97	-	-	-
	<b>Euro 2</b>	1998.01	2.2	-	0.50	-	-	-
	<b>Euro 3</b>	2000.01	2.3	0.20	-	0.15	-	-
	<b>Euro 4</b>	2005.01	1.0	0.1	-	0.08	-	-
	<b>Euro 5</b>	2009.09 <sup>b</sup>	1.0	0.10 <sup>g</sup>	-	0.06	0.005 <sup>e,f</sup>	-
<b>N<sub>1</sub>, klasa II 1305-1760 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	5.17	-	1.40	-	-	-
	<b>Euro 2</b>	1998.01	4.0	-	0.65	-	-	-
	<b>Euro 3</b>	2001.01	4.17	0.25	-	0.18	-	-
	<b>Euro 4</b>	2006.01	1.81	0.13	-	0.10	-	-
	<b>Euro 5</b>	2010.09 <sup>c</sup>	1.81	0.13 <sup>h</sup>	-	0.075	0.005 <sup>e,f</sup>	-
<b>N<sub>1</sub>, klasa III &gt;1760 kg</b>	<b>Euro 1</b>	1994.10	6.90	-	1.70	-	-	-
	<b>Euro 2</b>	1998.01	5.0	-	0.80	-	-	-
	<b>Euro 3</b>	2001.01	5.22	0.29	-	0.21	-	-
	<b>Euro 4</b>	2006.01	2.27	0.16	-	0.11	-	-
	<b>Euro 5</b>	2010.09 <sup>c</sup>	2.27	0.16 <sup>i</sup>	-	0.082	0.005 <sup>e,f</sup>	-
<b>Shënime:</b>								

† Për euro 1,2 për kategorinë N<sub>1</sub> klasat e masë referencës janë: klasa I ≤ 1250 kg, klasa II 1250-1700 kg, klasa III > 1700 kg

a. deri 1999.09.30 (mbas kësaj date motorët DI duhet të arrijnë limitet e IDI)

b. 2011.01 për të gjitha modelet

c. 2012.01 për të gjitha modelet

d. 2013.01 për të gjitha modelet

e. aplikueshme vetëm për mjetet përdorin motorë DI

f. 0.0045 g/km që përdorin procedurat e matjes PMP

g. dhe NMHC = 0.068 g/km

h. dhe NMHC = 0.090 g/km

i. dhe NMHC = 0.108 g/km